

MANUAL UDHËZUES

MBI LEGJISLACIONIN PËR INVESTIMET STRATEGJIKE

invest in Albania

INDEKSI

A. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	7
1. Legjislacioni mbi investimet strategjike	
2. Mekanizmat nxitës që ofron legjislacioni për investimet strategjike	
a) Dritare unike	
b) Procedura administrative me prioritet	
c) Afate të përshpejtuara	
d) Pajisje me leje, licenca dhe autorizime	
e) Shërbime ndaj investitorëve	
f) Masa mbështetëse	
3. Investime strategjike	8
a) Sektorë ekonomikë strategjikë	
b) Vlera e investimit	
4. Propozuesit e projekteve dhe investimeve strategjike	12
5. Prioriteti i procedurave administrative të investimeve strategjike	12
6. Statuset strategjike dhe procedurat e përshpejtuara	13
a) Projekt potencial strategjik:	
b) Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar	
c) Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë	
B. PROCEDURAT ADMINISTRATIVE TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE	17
1. Faza paraprake e shprehjes së interesit	
2. Faza e propozimit dhe vlerësimit të një projekti strategjik	18
a) Propozimi dhe vlerësimi i projekteve potencial strategjike	
b) Propozimi dhe vlerësimi i projekteve me procedurë të asistuar ose procedurë të veçantë	
3. Faza e realizimit të një projekti strategjik	26
a) Asistenca dhe shërbimet pas miratimit të statusit strategjik	
b) Asistenca e ofruar në lidhje me licencat/lejet/autorizimet	
c) Masat mbështetëse shtesë pas miratimit të statusit "investim strategjik, procedurë e asistuar" ose "investim strategjik, procedurë e veçantë"	
d) Masa mbështetëse të posaçme, për investimet strategjike me procedurë të veçantë	
4. Tarifat e procedurave të investimeve strategjike	32
a) tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative;	
b) tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike	
C. ORGANET LIGJZBATUESE	37
1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve	
2. Grupi Operacional	
3. Komiteti i Investimeve Strategjike	38
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	39
5. Ministrinë e linjës	40
6. Këshilli i Ministrave	40
7. Organe të tjera publike	41
D. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	49
1. Procedurat dhe afatet për shkëmbimin e informacionit	
2. Masat disiplinore për mospërbushjen e detyrave	
3. Kundërvajtjet administrative	
ANEKSI 1 - PËRKUFIZIMET LIGJORE	49
ANEKSI 2 - LISTA E SHKURTIMEVE	50



INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Legjisllacioni mbi investimet strategjike

2. Mekanizmat nxitës që ofron legjisllacioni për investimet strategjike
 - a) Dritare unike
 - b) Procedura administrative me prioritet
 - c) Afate të përshpejtuara
 - d) Pajisje me leje, licenca dhe autorizime
 - e) Shërbime ndaj investitorëve
 - f) Masa mbështetëse
3. Investime strategjike
 - a) Sektorë ekonomikë strategjikë
 - b) Vlera e investimit
4. Propozuesit e projekteve dhe investimeve strategjike
5. Prioriteti i procedurave administrative të investimeve strategjike
6. Statuset strategjike dhe procedurat e përshpejtuara
 - a) Projekt potencial strategjik:
 - b) Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar
 - c) Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë

A. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1. Legjislacioni mbi investimet strategjike

Legjislacioni i posaçëm për investimet strategjike synon nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike. Qëllimi i legjislatorit është të tërheqë investimet me kapital të konsiderueshëm të cilët zbatohen në sektorët ekonomikë të cilët konsiderohen si strategjikë për zhvillimin e vendit. Objektivat e këtij legjislacioni janë të lidhura me zhvillimin e ekonomik të vendit, punësimin dhe zhvillimin e rajoneve.

Për këtë qëllim, legjislacioni u ofron investitorëve strategjike mekanizma nxitës dhe mbështetës, duke i konsideruar këto investime si prioritare dhe duke u garantuar një sërë masash, shërbimesh dhe lehtësi administrative.

Paketa ligjore mbi investimet strategjike, përbëhet nga legjislacioni i mëposhtëm:

- Ligj nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 16.12.2015, "Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1024, datë 16.12.2015, "Për miratimin e projekteve me statusin Projekt me potencial strategjik";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2015, "Për shërbimet e promovimit dhe përfaqësimit të investimeve strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1027, datë 16.12.2015, "Për tarifatat e shërbimeve për investimet strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1028, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1029, datë 16.12.2015, "Për bashkëpunimin ndërinstitucional në procedurat e investimeve strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1030, datë 16.12.2015, "Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1031, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e rregullave për funksionimin, krijimin, administrimin dhe për formatin, përmbajtjen e procedurat për sigurinë e Regjistrit të Investimeve Strategjike";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1032, datë 16.12.2015, "Për dokumentimin e marrëveshjeve të investitorëve strategjikë me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private"

2. Mekanizmat nxitës që ofron legjislacioni për investimet strategjike

Legjislacioni mbi investimet strategjike ofron një sërë avantazhesh në favor të realizimit të investimeve strategjike. Këto avantazhe përfshijnë, midis të tjerash:

a) Dritare unike

Investitorët strategjikë mund ti kryejnë të gjithë veprimet e nevojshme nëpërmjet një sporteli të vetëm. AIDA është sporteli unik për investitorët strategjikë dhe ndjek në favor të tyre, të gjitha procedurat administrative që nga momenti i paraqitjes së aplikimit e deri në përfundimin e investimit strategjik.

b) Procedura administrative me prioritet

Procedurat administrative në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e një projekti investues strategjik, janë me prioritet, renditen të parat në radhë dhe ndiqen me procedurë të përshpejtuar nga administrata publike

c) Afate të përshpejtuar

Administrata publike, kryen procedurat në lidhje me investimet strategjike brenda afateve të posaçme, të shpejta dhe me urgjencë.

d) Pajisje me leje, licenca dhe autorizime

Procedurat administrative për lëshimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe mendimeve, në lidhje me projektet dhe investimet strategjike, trajtohen me prioritet, renditen të parat në radhë dhe përfundojnë brenda afateve të përshpejtuar. AIDA asiston investitorët për pajisjen me lejet e nevojshme për realizimin e një investimi strategjik.

e) Shërbime ndaj investitorëve

Në mbështetje të investimeve strategjike, AIDA ofron një sërë shërbimesh të ndryshme;

- kryen veprimet përgatitore për hartimin e një projekti strategjik;
- ofron shërbime analize dhe vlerësimi të investimit;
- koordinon informacionin midis investitorëve dhe administratës publike;
- përfaqëson investitorët tek autoritet publike përgjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve strategjike;
- asiston investitorët në nxjerrjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme;
- asiston investitorët në veprimet në lidhje me konsolidimin e tokës.

f) Masa mbështetëse të ofruara nga shteti shqiptar

Shteti shqiptar mund të ofrojë edhe masa të tjera mbështetëse me qëllim realizimin e investimeve strategjike. Këto masa mbështetëse përfshijnë:

- mbështetje e investimit me infrastrukturë ndihmëse;
- përdorim i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike;
- shpronësim të pasurive të paluajtshme, pronë private, për interes publik;
- miratim nga ana e Kuvendit të kontratave përkatëse të investimit strategjik;
- drejtë e përdorimit të brigjeve;
- pjesëmarrje shtetërore në investimin strategjik.

3. Investime strategjike

Investime strategjike konsiderohen investimet e kryera:

a) në një nga sektorët ekonomikë strategjikë:

b) me vlera investimi mbi kufijtë minimalë të secilit sektor ekonomik strategjik.

Përpos këtyre investimeve, investime strategjike me procedurë e veçantë konsiderohen gjithashtu edhe:

c) Investimet me vlerë të barabartë ose mbi 100 milionë euro

* * *

a) Sektorët ekonomikë strategjikë

Sektorë ekonomikë strategjikë konsiderohen nga shteti shqiptar ato sektorë të cilat kanë potencial të lartë për zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe përfshijnë:

- I. energjetika dhe sektori mineral;
- II. transporti, infrastruktura e komunikimeve elektronike dhe mbetje urbane;
- III. turizmi;
- IV. bujqësia dhe peshkimi;
- V. zonat e teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik;
- VI. zonat me përparësi zhvillimi.

Brenda secilit prej këtyre makro sektorëve, legjislacioni ka detajuar edhe veprimtaritë konkrete sipas nën sektorëve specifike.

► Nënsektorët strategjikë

I. Sektori strategjik energjetik dhe mineral, përfshin:

- nënsektori energjetik përfshin investimet strategjike në fushat e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike;
- nënsektori i hidrokarbureve përfshin investimet strategjike në fushat e kërkimit, zhvillimit, nxjerrjes, prodhimit, ndarjes, përpunimit, grumbullimit, transportimit e shpërndarjes së naftës bruto e nënprodukteve hidrokarbure, veprimtaritë në fushën e transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, depozitimit, furnizimit, si dhe të atyre për ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror;
- nënsektori mineral përfshin investimet strategjike në fushat e kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit të mjedisit mineral.

II. Sektoristategjiktransport,infrastrukturëekomunikimeveelektronikedhembetjeturbane,nëtëcilin:

- nënsektori i transportit detar përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e porteve detare, zonave portuale dhe marinave, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit detar të mallrave dhe pasagjerëve;
- nënsektori i transportit ajror përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e aeroporteve, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit ajror të mallrave dhe pasagjerëve;
- nënsektori i transportit hekurudhor përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e infrastrukturës hekurudhore, si dhe ofrimin e shërbimeve të

transportit hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve;

- nënsektori i transportit rrugor përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e rrugëve rajonale dhe kombëtare, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit rrugor të mallrave dhe pasagjerëve;
- nënsektori i rrjeteve të transportit përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e rrjeteve alternative të transportit, të tilla si tram, metro apo transporte alternative të ngjashme, si dhe ofrimin e shërbimeve të transportit të pasagjerëve në to;
- nënsektori i komunikimeve elektronike, përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen, administrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, si dhe ofrimin e shërbimeve të aksesit të këtyre rrjeteve për përdoruesit;
- nënsektori i mbetjeve urbane përfshin investimet strategjike në veprimtaritë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë grumbullimin, transportin, rikuperimin, asgjësimin e mbetjeve, ndërtimin, rikualifikimin, administrimin dhe kujdesin për mbylljen e landfillleve;
- nënsektori i ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, rehabilitimin dhe/ose mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë, sistemit të kanalizimeve, si dhe të impianteve të ujërave të ndotura.

III. Sektori strategjik i turizmit, në të cilin nënsektori i strukturave turistike përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e strukturave turistike akomoduese, të konsideruara si sipërmarrje turistike, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit për turizmin.

IV. Sektori strategjik i bujqësisë dhe peshkimit, në të cilin:

- nënsektori i prodhimit bujqësor përfshin investimet strategjike që kanë si model fermat e mëdha bujqësore;
- nënsektori i infrastrukturës së blegtorisë përfshin investimet strategjike që krijojnë dhe administrojnë infrastrukturën e nevojshme për blegtorinë dhe ofrojnë shërbimet e lidhura me shpërndarjen e produkteve blegtorale;
- nënsektori i infrastrukturës së peshkimit përfshin investimet strategjike që kanë si objekt ndërtimin dhe administrimin e infrastrukturave të peshkimit dhe akuakulturës si edhe ofrimin e shërbimeve për shpërndarjen e produkteve të peshkimit.

V. Sektori strategjik i zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, përfshin investimet strategjike në lidhje me ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e parqeve industriale/teknologjike e të inovacionit, si dhe pajisjen me infrastrukturën e nevojshme për prodhim, zhvillim industrial, tregtimin dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura me veprimtaritë që ushtrohen brenda tyre.

VI. Zonat me përparësi zhvillimi

“Zona me përparësi zhvillimi” janë zonat rajonale dhe/ose lokale të qeverisjes vendore, të cilat konsiderohen si zona të një rëndësie të veçantë dhe që kanë nevojë për mbështetje të posaçme me qëllim zhvillimin ekonomik, nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shfrytëzimin me efikasitet të burimeve e infrastrukturave publike.

Zhvillimi i zonave me përparësi zhvillimin fokusohet kryesisht në drejtimet e mëposhtme:

- Orientimi i investimeve në zona të caktuara territoriale, me qëllim nxitjen e përqendrimit të llojeve të njëjta apo të ngjashme të industrive apo veprimtarive tregtare, në mënyrë që

të përfitohet nga specializimi i punëkërkuësve, ekonomitë e shkallës dhe ndarja e kostove infrastrukturore. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës të cilat synojnë rritjen e efikasitetit të infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim si edhe do të ndërmerren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet industriale;

- Orientimi i investimeve në zona të caktuara territoriale në të cilat ka nivele të larta papunësie dhe ku zhvillimi ekonomik është në nivele të pakënaqshme, krahasuar me rajone të tjera të vendit. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës të cilat synojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullatës, rritjen e punësimit dhe formimit profesional si edhe përmirësimin e infrastrukturave.

► Identifikimi, shpallja dhe funksionimi i zonave me përparësi zhvillimi

Kriteret ndihmës për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimin janë:

- studimi i vendndodhjes, përqendrimit, numrit dhe rëndësisë ekonomike të veprimtarive industriale dhe tregtare ekzistuese, me qëllim krijimin e sinergjive ekonomike midis tyre;
- analiza e gjendjes së infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim;
- niveli i papunësisë së zonës;
- të ardhurat ekonomike për banor si edhe kriteret e tjera ndihmës, sipas nevojave dhe strategjive publike;
- realizimi i objektivave të mbrojtjes efektive mjedisore;
- shfrytëzimi me efektivitet të aftësive e kualifikimeve të veçanta të punëkërkuësve aktivë të zonës;
- statistikave të zhvillimit ekonomik të zonës përkatëse sipas studimeve të INSTAT apo enteve të tjera publike;

Propozimi për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimin mund të bëhet nga ministrat e linjës, AIDA dhe KIS.

Identifikimi, shpallja dhe përcaktimi i mënyrës dhe i rregullave të funksionimit të zonave të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi, kryhet rast pas rasti nga Këshilli i Ministrave me vendim të posaçëm.

b) Vlera e investimit strategjik

Vlera e investimit është vlera totale e investuar nga investitori deri në momentin që projekti bëhet operacional. Vlerat e investimit minimale për secilin sektor strategjik janë:

- I. sektori energjetik dhe minerar:
 - 30.000.000 (tridhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e asistuar;
 - 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e veçantë.
- II. transport, infrastrukturë e komunikimeve elektronike dhe mbetje urbane
 - 30.000.000 (tridhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e asistuar;
 - 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e veçantë.
- III. turizëm
 - 5.000.000 (pesë milionë) euro dhe që krijon 80 vende të reja pune, për statusin procedurë e asistuar;
 - 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e veçantë.

IV. bujqësi dhe peshkim;

- 3.000.000 (tre milionë) euro dhe që krijon 50 vende të reja pune, për statusin procedurë e asistuar;
- 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e veçantë.

V. zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;

- 5.000.000 (pesë milionë) euro, për statusin procedurë e asistuar;
- 50.000.000 (pesëdhjetë milionë) euro, për statusin procedurë e veçantë.

VI. zona me përparësi zhvillimi.

- 1.000.000 (një milion) euro dhe që krijon 150 vende të reja pune, për statusin procedurë e asistuar;
- 10.000.000 (dhjetë milion) euro dhe që krijon 600 vende të reja pune, për statusin procedurë e asistuar;

Pra, nëse një investim, plotëson njëkohësisht dy kushtet e mësipërme: zhvillohet në njërin prej sektorëve ekonomikë të konsideruar strategjike dhe ka një vlerë totale investimi mbi kufijtë ekonomikë të mësipërm, mund të përfitojë procedura administrative lehtësuese, të kryera në afate të përspejtuara, si edhe të gëzojë shërbime dhe masa mbështetëse të ofruara nga shteti shqiptar.

c) Investime me vlerë 100 milionë euro

Statusin investim strategjik procedurë e veçantë e përfitojnë edhe projektet të cilat, pavarësisht se nuk janë parashikuar të realizohen në një nga sektorët strategjike, kanë vlerë totale investimi të barabartë ose më të madhe se 100.000.000 (njëqind milionë) euro.

4. Propozuesit e projekteve dhe investimeve strategjike:

Investimet strategjike mund të propozohen nga:

- Subjektet investues të interesuar, persona juridikë privatë, vendas ose të huaj;
- Ministrat e linjës, sipas sektorit të projektit investues.

Të gjitha propozimet, nga të gjithë propozuesit, kryhen nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

5. Prioriteti i procedurave administrative të investimeve strategjike

Procedurat administrative të investimeve strategjike në lidhje me përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik, si dhe me lëshimin e licencave/lejeve/autorizimeve dhe mendimeve, janë me prioritet, renditen të parat në radhë dhe ndiqen me procedurë të përspejtuara për të gjitha autoritetet publike, shtetërore, të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këto procedura.

Procedurat e investimeve strategjike përqendrohen nëpërmjet mekanizmit të "dritares unike", pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA). AIDA luan rolin e agjentit asistues të investitorëve dhe është struktura kompetente për dhënien e shërbimeve për investitorët dhe projektet strategjike.

Midis të tjerash, AIDA:

- ndjek të gjitha procedurat administrative, që nga momenti i paraqitjes së një propozimi investues e deri në përfundimin e të gjitha procedurave administrative, për realizimin e projektit investues;
- kryen veprimet përgatitore për hartimin e një projekti strategjik;
- ofron shërbime analize dhe vlerësimi të investimit;
- koordinon informacionin midis investitorëve dhe administratës publike;
- përfaqëson investitorët tek autoritet publike përgjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve strategjike;
- asiston investitorët në nxjerrjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme.

Të gjitha autoritetet publike shtetërore detyrohen të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, sqarime, informacione dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me realizimin e një projekti investues strategjik, në përputhje me procedurat dhe afatet e veçanta të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike.

6. Statuset strategjike dhe procedurat e përshpejtuara

Investimeve strategjike legjislacioni u ofron staturë preferenciale për të cilat zbatohen procedura të përshpejtuara. Statuset preferenciale miratohen nga Komiteti i Investimeve Strategjike. Për secilin status, legjislacioni parashikon kryerjen e procedurave favorizuese përkatëse. Statuset dhe procedurat preferenciale të projekteve strategjike janë:

a) *Projekt potencial strategjik:*

Projekti potencial strategjik është një projekt i mundshëm investimi, me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik. Ky status është paraprak dhe i garantohet projekteve të konsideruara me potencial strategjik, deri në momentin e dhënies së statusit "Investim/investitor strategjik".

b) *Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar:*

Procedura e asistuar është procedura e posaçme sipas së cilës administrata publike ndjek, koordinon, asiston, mbikëqyr dhe përfaqëson investimin strategjik përgjatë fazave të zbatimit të tij.

c) *Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë*

Procedurë e veçantë është procedura e posaçme me të cilën jepet mbështetje me rregulla të veçanta për investime strategjike me ndikim në ekonomi, punësim, industri, teknologji dhe/ose zhvillim rajonal, me synim lehtësimin dhe përshpejtimin e investimeve.

B

PROCEDURAT ADMINISTRATIVE TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

1. Faza paraprake e shprehjes së interesit
2. Faza e propozimit dhe vlerësimit të një projekti strategjik
 - a) Propozimi dhe vlerësimi i projekteve potencial strategjike
 - b) Propozimi dhe vlerësimi i projekteve me procedurë të asistuar ose procedurë të veçantë
3. Faza e realizimit të një projekti strategjik
 - a) Asistenca dhe shërbimet pas miratimit të statusit strategjik
 - b) Asistenca e ofruar në lidhje me licencat/lejet/autorizimet
 - c) Masat mbështetëse shtesë pas miratimit të statusit "investim strategjik, procedurë e asistuar" ose "investim strategjik, procedurë e veçantë"
 - d) Masa mbështetëse të posaçme, për investimet strategjike me procedurë të veçantë
4. Tarifat e procedurave të investimeve strategjike
 - a) tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative;
 - b) tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike

B. PROCEDURAT ADMNISTRATIVE PËR INVESTIMET STRATEGJIKE

1. Faza paraprake e shprehjes së interesit

Në këtë faze eventuale, propozuesi i një projekti strategjik kërkon informacion në lidhje me një projekt të mundshëm, dokumentacionin e kërkuar dhe realizimin e tij. Kjo shprehje interesi, kërkesë për informacion apo sqarim, duhet të paraqitet me shkrim pranë AIDA.

Agjencia vlerëson fillimisht nëse projekti i paraqitur i përket sektorëve dhe nën sektorëve strategjike, si edhe nëse investimi i kalon vlerat minimale të investimit. Gjithashtu AIDA verifikon nëse projekti mbivendoset me projekte apo aktivitete të tjera, të miratuara më parë.

Agjencia analizon paraprakisht profilin e investitorit. Për këtë qëllim ka të drejtë t'i kërkojë investitorit informacione lidhur me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e investimit, deklaratat financiare, strukturën menaxheriale, pronësinë, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme, lidhur me fushën e investimit, projekte të ngjashme, si dhe komponentë të tjerë të nevojshëm për të provuar aftësitë e tij investuese dhe potencialin për të qenë investitor strategjik për projektet e investimeve strategjike, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

AIDA i kërkon informacione dhe detaje edhe organeve të tjera shtetërore të përfshira në realizimin e projektit specifik.

AIDA i jep propozuesit informacionin informues mbi projektin dhe mënyrën sesi duhet të plotësohet aplikimi dhe dokumentacioni përkatës, për fillimin e vlerësimit të propozimit. Për këtë qëllim AIDA i jep edhe listën me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për projektin (lejet e nevojshme, organet kompetente, dokumentacioni për marrjen e tyre, dokumentacioni teknik, ekonomik dhe financiar i kërkuar etj).

Pas përgatitjes së këtyre dokumenteve, subjekti mund të paraqitet tek Agjencia me projektin dhe dokumentacionin e plotësuar dhe të aplikojë për fillimin e procedurave.

Përgjatë kësaj faze, zbatohen procedurat dhe afatet e zakonshme të bashkëpunimit dhe komunikimit midis organeve të administratës publike dhe investitorit, meqenëse në këtë fazë paraprake, ende nuk kanë filluar formalisht procedurat administrative të parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike.

2. Faza e propozimit dhe vlerësimit të një projekti strategjik

Propozuesit e një projekti strategjik, mund të aplikojnë për përfitimin e njërit prej statuseve preferenciale strategjike të mëposhtëm:

- “projekt potencial strategjik”;
- “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”;
- “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

Propozuesit mund të aplikojnë fillimisht për përfitimin e statusit “projekt potencial strategjik”, në rast se projekti është në fazën e projekt idesë dhe ka nevojë për mbledhje të informacionit dhe të dokumentacionit që disponohet nga ana e organeve shtetërore.

Dobishmëria e kësaj procedure, në favor të investitorit lidhet me faktin që AIDA i mundëson atyre, brenda afateve të shkurtra, mbledhjen e të gjithë informacionit, të dhënave, dokumentacionit, ekspertizës apo njohurive, të cilat disponohen nga organet e administratës publike dhe janë të nevojshme për hartimin e plotë të një projekti strategjik.

Ndërsa në rastin kur është përgatitur një projekt konkret dhe i detajuar, i gatshëm për tu vlerësuar nga autoritetet kompetente, propozuesit mund të aplikojnë menjëherë për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” ose për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”.

Përgjatë procedurës së asistuar apo të veçantë, investitori përfiton asistencën, shërbimet dhe masat mbështetëse që aplikohen në fazën zbatuese të investimit.

Të gjitha aplikimet kryhen pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

a) Propozimi dhe vlerësimi i projekteve potencial strategjike

Aplikimi për përfitimin e statusit të projektit potencial strategjik është hapi fillestar i procedurave administrative për vlerësimin e investimeve strategjike. Ky status konsiderohet si një status paraprak dhe në rast se miratohet, zgjat deri në momentin kur përfitohet statusi përfundimtar “Investim/investitor strategjik: procedurë e asistuar/ procedurë e veçantë”.

Në këtë rast, bëhet fjalë për një projekt të mundshëm investimi, i cili është ende në fazën e projekt idesë, i cili parashikohet se mund të ketë ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik.

Projektet të cilat përfitojnë statusin “projekt me potencial strategjik”, mbështeten nëpërmjet zbatimit të procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese, si edhe dhënies së asistencës dhe ofrimit të shërbimeve ndaj investitorëve.

Projektet me potencial strategjik, përfitojnë nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, asistencë për mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor, administrativ etj., të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e investimit. Gjithashtu Agjencia kryen të gjitha veprimet përgatitore, si dhe ofron shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik, përfshirë shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, si dhe shërbime përfaqësimi të investitorit tek autoritetet publike.

Statusi i projektit potencial strategjik duhet të propozohet që nga momenti i nismës për të hartuar projektin.

Propozimi i projektit potencial strategjik mund të bëhet nga:

- I. ministrat e linjës ose:
- II. investitorët privatë.

I. Propozimi i projektit potencial strategjik nga ministrat e linjës;

Ministrat e linjës përgjegjës propozojnë dhënien e statusit potencial strategjik për ato projekte të konsideruara me interes publik, të propozuara nga organet shtetërore të qeverisjes qendrore apo vendore, për të cilat synohet realizimi i tyre nëpërmjet investimit nga subjektet private dhe për të cilat legjislacioni në fuqi parashikon kryerjen e procedurave konkurruese, koncesionare, të partneritetit publik, të prokurimeve publike, nëpërmjet garave, konkurseve apo tenderave publike.

Projektet duhet tu përkasin sektorëve ekonomikë strategjike dhe vlerave të investimit të parashikuara nga legjislacioni i posaçëm për investimet strategjike dhe duhet shoqëruar me një relacion shpjegues në lidhje me potencialin strategjik të projektit të propozuar.

Në këto raste statusi i projektit potencial strategjik dhe asistenca përkatëse, u ofrohet në mënyrë transparente dhe pa asnjë diskriminim, të gjithë subjekteve pjesëmarrës në garën, konkursin apo tenderin e shpallur nga organet shtetërore, të cilët paraqesin kërkesën për përfitimin e statusit potencial strategjik dhe që plotësojnë kushtet ligjore.

Subjekti i cili rezulton fitues në përfundim të procedurave konkurruese, mund të aplikojë më tej për përfitimin e statusit "Investim/investitor strategjik: procedurë e asistuar/procedurë e veçantë".

Qëllimi i kësaj procedure, në rastet kur propozohet nga ministrat e linjës, është që të favorizohet hartimi dhe përgatitja e atyre projekteve të cilat konsiderohen strategjike nga ministratë përkatëse dhe për të cilat synohet tërheqja e investitorëve strategjike private, me qëllim zbatimin e tyre.

Në rastet kur propozimi paraqitet nga ministrat, kërkesa i përcillet Agjencisë dhe shoqërohet me një relacion shpjegues mbi rëndësinë strategjike të projektit, i cili duhet të përmbajë përshkrimin e detajuar të elementëve të mëposhtëm:

- vlerën totale të parashikuar të investimit;
- kohën e nevojshme për realizimin e investimit;
- produktivitetin dhe vlerën e shtuar që do të sjellë investimi;
- mundësitë e punësimit dhe hapja e vendeve të reja të punës që parashikohen si pasojë e investimit;
- përputhshmërinë e projektit me politikën dhe prioritetet ekonomike sektoriale;
- mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal që paraqet investimi;
- mundësitë e zhvillimit dhe përmirësimit të kushteve e standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që paraqet investimi;
- teknologjitë e reja që sjell investimi, të cilat rrisin konkurrencën dhe efektivitetin;
- rritjen e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve, si pasojë e realizimit të investimit;
- mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit që garanton projekti.

II. Propozimi i projektit potencial strategjik nga investitorët

Propozimi i një projekti potencial strategjik mund të bëhet edhe nga një investitor privat. Në këtë rast synohet asistenca e organeve shtetërore, për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme, brenda afateve të shkurtra, me qëllim hartimin e një projekti strategjik.

Në rastet kur propozimi paraqitet nga investitori propozues i projektit, kërkesa duhet të shoqërohet me plan biznesin e investimit, ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- identiteti i investitorit dhe i partnerëve të tij;
- përshkrimi i detajuar i projektit të investimit;
- përshkrimi i detajuar i punëve që do të realizohen dhe shërbimeve që do të ofrohen sipas projektit investues;
- analizë e detajuar e afateve kohore që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e realizimit të tij;

- përshkrimi i karakteristikave të investimit që i referohen specifikisht zhvillimit të teknologjive të reja dhe mbrojtjes së mjedisit
- analizë financiare e të gjithë projektit investues, si dhe analizë e shpenzimeve financiare që do të nevojiten për realizimin e çdo faze të projektit;
- analizë e detajuar mbi impaktin që punët dhe shërbimet e projektit mund të kenë mbi mjedisin dhe në planet urbanistike;
- analizë e detajuar e impaktit ekonomik dhe social të pritshëm nga realizimi i projektit investues;
- analizë e përfitimeve me interes publik që parashikohet të ketë shteti shqiptar nga realizimi i projektit;

► Procesi i vlerësimit të një propozimi për projektet me potencial strategjik

Projektet me statusin “projekt me potencial strategjik”, miratohen nga Komiteti i Investimeve Strategjike, pasi të jenë kryer procedurat dhe vlerësimet paraprake nga ana e Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Për këtë qëllim, Agjencia organizon grupe operacionale specifike, të cilat kanë në përbërje ekspertë të ministrive të linjës, të fushat në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik, për të asistuar dhe mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen e projektit potencial strategjik.

Për kryerjen e vlerësimit të projekteve Agjencia ka të drejtë të kërkojë mendime dhe opinione nga Autoriteti i Konkurrencës, njësitë përkatëse të qeverisjes vendore apo agjenci ose institucione të tjera.

Agjencia kryen verifikimin e dokumentacionit të projektit, brenda një afati prej 30 ditësh pune nga data e paraqitjes së dosjes së plotë të informacionit nga propozuesi. Nëse konstaton se dokumentacioni është i paplotë, Agjencia i kërkon, me shkrim, subjektit investues plotësimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara. Subjekti investues duhet të plotësojë dokumentacionin brenda një afati 10-ditor nga dita e marrjes së njoftimit.

Agjencia vlerëson fillimisht nëse projekti i paraqitur i përket sektorëve dhe nën sektorëve strategjike, si edhe nëse investimi i kalon vlerat minimale të investimit. Gjithashtu AIDA verifikon nëse projekti mbivendoset me projekte apo aktivitete të tjera, të miratuara më parë.

Agjencia vlerëson paraprakisht potencialin strategjik të një projekti, bazuar në interesin publik dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit.

Përcaktimi i interesit publik në përzgjedhjen e një investimi strategjik vlerësohet sipas:

- vlerës së investimit;
- kohës së realizimit të investimit;
- produktivitetit dhe vlerës së shtuar të investimit;
- hapjes së vendeve të reja të punës;
- prioritetit ekonomik sektorial;
- zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal;
- zhvillimit apo përmirësimit të kushteve dhe standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve;

- ofrimin të teknologjive të reja për të rritur konkurrencën dhe efektivitetin e investimit;
- rritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve;
- mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit.

Parimet e proporcionalitetit bazohen mbi vlerësimin se kushtet e veçanta dhe nxitëse zbatohen deri në atë shkallë sa të mos shuajnë riskun operacional, duke respektuar parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në procedura dhe treg. Risku operacional i një investimi të propozuar, vendas apo të huaj, duhet të qëndrojë gjithmonë në anën e investitorit. Gjithashtu, kushtet e veçanta dhe nxitëse zbatohen proporcionalisht, si në raport me vlerën dhe rëndësinë e investimit, ashtu edhe me interesin dhe dobinë publike të investimit të propozuar.

Në përfundim të vlerësimit, AIDA përcjell tek Komiteti i Investimeve Strategjike, i cili është organi kompetent për miratimin e statusit potencial strategjik, dokumentacionin dhe rekomandimin e saj në lidhje me miratimin apo refuzimin e statusit potencial strategjik.

Agjencia informon KIS mbi të gjitha projektet e paraqitura, procedurat e kryera, analizën e kryer dhe rekomandimet e hartuara prej saj. Pavarësisht nga vlerësimi pozitiv apo negativ i Agjencisë, çdo aplikim i paraqitet për shqyrtim KIS, i shoqëruar me propozimin pozitiv apo negativ të Agjencisë, si dhe miratimin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë për përfitimin e statusit "projekt me potencial strategjik".

Komiteti i Investimeve Strategjike, pas shqyrtimit të projektit dhe të analizës përfundimtare të paraqitur nga Agjencia, merr një vendim për pranimin apo refuzimin e kërkesës brenda një afati prej 30 ditësh pune nga data e dorëzimit të propozimit nga Agjencia.

Nëse KIS konstaton se dokumentacioni është i paplotë apo ka nevojë për informacione shtesë, nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, i kërkon propozuesit të projektit, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënave të kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike. Propozuesi i projektit duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së njoftimit. Në këto raste, afati 30-ditor i vendimmarrjes zgjatet deri në plotësimin e dokumentacionit dhe shqyrtimin përfundimtar nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike.

Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike i njoftohet, me shkrim, kërkuar nga Agjencia.

Vendimi i KIS në lidhje me refuzimin e statusit potencial strategjik, nuk paragjykon rezultatin e procedurave konkurruese dhe nuk e pengon investitorin të vijojë realizimin e projektit, bazuar në procedurat normale të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

► Asistenca e ofruar për projektet me potencial strategjik

Me marrjen e statusit "projekt me potencial strategjik" investitori ka të drejtë të përfitojë:

- asistencë nga AIDA në lidhje me mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor, administrativ etj., të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e projektit të investimit. Agjencia kryen të gjitha veprimet përgatitore, si dhe ofron shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik, përfshirë shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, si dhe shërbime përfaqësimi të investitorit tek autoritetet publike.
- asistencën e mëtejshme të Agjencisë për përfitimin e statusit përfundimtar "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

b) Propozimi dhe vlerësimi i projekteve me procedurë të asistuar ose procedurë të veçantë

Çdo subjekt investues i interesuar, person juridik privat, vendas ose i huaj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për investimet strategjike, ka të drejtën për të kërkuar përfshirjen e një projekti investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Këto procedura u ofrohen projekteve konkrete të investimit, të cilat janë përgatitur dhe detajuar plotësisht nga propozuesi. Projekti i investimit mund të jetë projekt i cili paraqitet për herë të parë për miratim, ose mund të jetë një projekt i cili është paraqitur paraprakisht dhe ka fituar statusin e "projektit potencial strategjik".

Gjithashtu mund të aplikojnë edhe ato investime strategjike, të cilat janë në proces të zhvillimit të tyre dhe për të cilat nuk është nënshkruar ende një kontratë ndërmjet autoritetit publik dhe investitorit strategjik, si dhe ato investime strategjike, për të cilat është nënshkruar një kontratë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që klasifikohen investime strategjike, në kuptim të këtij ligji, me qëllim realizimin dhe konkretizimin e tyre.

Masat mbështetëse të përcaktuara në kreun VII të ligjit për investimet strategjike, nuk aplikohen për kontratat e investimeve të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji (01 Tetor 2015).

► Dokumentacioni i kërkuar për përfitimin e statusit strategjik

Subjekti investues i interesuar, i cili kërkon të përfitojë marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", duhet të paraqesë tek AIDA:

- kërkesë me shkrim për përfitimin e statusit;
- planin e biznesit;
- planin dhe burimet e financimit;
- programin e punës dhe afatet e parashikuara për realizimin e projektit, të detajuara me fazat dhe veprimet përkatëse;
- vlerësimin e ndikimit social, ekonomik dhe strategjik të projektit;
- studimin e fizibilitetit;
- përfitimet ekonomike, sociale dhe operacionale, si dhe nivelin e punësimit, që parashikohen të realizohen;
- listën me të gjitha masat, incentivat dhe shërbimet mbështetëse që subjekti investues kërkon nga shteti shqiptar, për realizimin e projektit investues;
- dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e projektit në fjalë, sipas kërkesave të ligjit nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 1028, datë 16.12.2015, "Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike";
- deklaratën e subjektit investues të interesuar me anë të së cilës subjekti merr përsipër dhe garanton vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura në dosje;
- autorizimin me shkrim nga ana e investitorit, me të cilin autorizohet AIDA, për të kryer të gjitha verifikimet e nevojshme të të dhënave të paraqitura në dosje
- pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht

nga subjekti i interesuar:

- mandatpagesën e tarifave të aplikueshme.

Gjithashtu subjektet e interesuara paraqesin dokumentacionin i cili vërteton se subjekti:

- nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
- nuk është dënuar, me vendim gjykatë të formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- kapitalet dhe asetet nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, nga ana e shërbimit përmbartimor;
- ka përmbushur, rregullisht, detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe tatimeve;
- ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Dokumentacioni i kërkuar paraqitet në format dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

Në çdo rast, AIDA ka detyrimin që të këshillojë, informojë dhe të komunikojë në mënyrë të vazhdueshme me subjektet investuese të interesuar, në lidhje me formën, modalitetet dhe procedurat specifike të dokumentacionit që duhet të paraqesë për një projekt specifik. Për këtë qëllim, Agjencia i jep subjekteve të interesuara, në mënyrë të qartë, transparente dhe brenda afateve të arsyeshme, listën e dokumentacionit të kërkuar për projektin përkatës, së bashku me udhëzimet dhe shpjegimet përkatëse, si dhe do i përgjigjet kërkesave për informacion të subjekteve të interesuar, brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës.

► Garancitë financiare

Investitorët e interesuar për realizimin e një investimi strategjik, të cilët kërkojnë marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", përveç dokumentacionit të kërkuar në lidhje me projektin, duhet të paraqesin edhe dokumentacionin që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues, si mënyrë garancie për zbatimin dhe zhvillimin e projektit.

Dokumentacioni që provon kapacitetet financiare për realizimin e projektit investues duhet të përmbajë të dhëna financiare, të cilat dëshmojnë aftësinë e investitorit për realizimin e investimit.

Kufiri minimal i garancive financiare të kërkuara është në masën jo më pak se 10 % të vlerës totale të investimit. KIS, në varësi të karakteristikave, përmasave dhe kompleksitetit të projektit, eksperiencës dhe kapaciteteve të investitorit si dhe në varësi të interesit publik, mund të kërkojë nivele më të larta të përqindjes së kapaciteteve financiare të kërkuara, por jo më tepër se 20 % të vlerës totale të investimit.

Vlera e kapaciteteve financiare të kërkuara për realizimin e investimit, mund të dëshmohet:

- nëpërmjet kapaciteteve financiare të vetë investitorit, të provuara dhe siç rezultojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe të depozituara pranë administratës tatimore të 3 viteve të fundit, kur kjo është e mundur, ose nëse është themeluar pas këtij afati, të viteve/vitit të fundit;
- nëpërmjet financimit dhe kreditimit të përshtatshëm nga ana e instituteve bankare ose financiare, vendase ose të huaj, me reputacion të mirënjohur dhe besueshmëri të lartë, ose
- nëpërmjet ofrimit të garancive financiare nga ana e instituteve bankare ose financiare, ven-

dase ose të huaj, me reputacion të mirënjohur dhe besueshmëri të lartë.

Të drejtat dhe detyrimet e palëve për kushtet dhe mënyrën e realizimit të investimit, si dhe ofrimin të garancive financiare përcaktohen nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje të posaçme, të cilat mund të nënshkruhen nga KIS, nga një organ tjetër i autorizuar prej tij ose nga organi përgjegjës i përcaktuar sipas legjislacionit specifik të veprimtarisë përkatëse.

Në rastin e investimeve për të cilat është nënshkruar një kontratë para hyrjes në fuqi të ligjit për investimet strategjike, të cilat kërkojnë të përfitojnë statusin e investimeve strategjike, për të cilën investitori ka realizuar mbi 10% të vlerës së investimit, KIS mund të konsiderojë të arsyeshme mos paraqitjen e garancisë financiare, me kusht që të paraqitet një certifikim i investimit të kryer, i hartuar nga vlerësues të licencuar sipas legjislacionit në fuqi dhe konfirmimit nga autoriteti kontraktues.

Garancitë dhe informacionet financiare për qëllimet e investimeve strategjike, nuk kërkohen në rastet e projekteve publike, të konsideruara si investime strategjike, të iniciuara dhe të financuara nga shteti, nëpërmjet fondeve buxhetore, granteve apo financimeve të ndryshme. Ky përcaktim nuk përjashton paraqitjen e garancive të tjera të kërkuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

- Procesi i vlerësimit të propozimeve për statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" ose "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Statusi "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar" ose "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", miratohet nga Komiteti i Investimeve Strategjike, pasi të jenë kryer procedurat dhe vlerësimet paraprake nga ana e Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve.

Vlerësimi i projektit nga Agjencia kryhet nëpërmjet grupeve operacionale të posaçme për çdo projekt, të përbërë nga ekspertë të ministrive të linjës, në fushat në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik. Grupet operacionale ngrihen rast pas rasti, sipas projekteve të paraqitura, me propozimin e AIDA, me nismën e Ministrit të MZHETTS, me anë të një urdhëri të përbashkët të ministrave të përfshirë në projektin e investimeve strategjike.

Për kryerjen e vlerësimit të projekteve Agjencia ka të drejtë të kërkojë mendime dhe opinione nga Autoriteti i Konkurrencës, njësitë përkatëse të qeverisjes vendore apo agjenci ose institucione të tjera.

Agjencia vlerëson fillimisht nëse projekti i paraqitur i përket sektorëve dhe nën sektorëve strategjike, si edhe nëse investimi i kalon vlerat minimale të investimit. Gjithashtu AIDA verifikon nëse projekti mbivendoset me projekte apo aktivitete të tjera, të miratuara më parë.

Vlerësimi paraprak i projektit nga AIDA bazohet mbi kriteret e mëposhtme:

- vlera totale e parashikuar e investimit;
- koha e nevojshme e realizimit të investimit të propozuar;
- produktiviteti dhe vlera e shtuar që vlerësohet se do të sjellë investimi;
- mundësitë e punësimit dhe hapja e vendeve të reja të punës që parashikohen si pasojë e investimit;
- përputhshmërinë e projektit me politikat dhe prioritetet ekonomike sektoriale;
- mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal që paraqet investimi;
- mundësitë e zhvillimit apo përmirësimit të kushteve dhe standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve që paraqet investimi;
- ofrimi i teknologjive të reja që sjell investimi dhe mundësitë për të rritur konkurrencën dhe efektivitetin e tregut;

- ndikimi që ka projekti për rritjen e nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve;
- nivelin e mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit që garanton investimi.

Agjencia kryen verifikimin e dokumentacionit të projektit, brenda një afati prej 30 ditësh pune nga data e paraqitjes së dosjes së plotë të informacionit nga propozuesi. Nëse konstaton se dokumentacioni është i paplotë, Agjencia i kërkon, me shkrim, subjektit investues plotësimin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të kërkuara. Subjekti investues duhet të plotësojë dokumentacionin brenda një afati 10-ditor nga dita e marrjes së njoftimit.

Agjencia, nëpërmjet grupit operacional, verifikon dokumentacionin e depozituar dhe kryen vlerësimin teknik, financiar e strategjik të projektit.

Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Agjencia dhe grupi operacional, nëse projekti dhe aplikimi i investitorit përmbushin kërkesat e legjislacionit, propozimi i përcillet KIS për miratim, sëbashku me rekomandimin përkatës "miratim/ refuzim/për plotësim".

Komiteti i Investimeve Strategjike, pas shqyrtimit të projektit dhe të analizës përfundimtare të paraqitur nga Agjencia, merr një vendim në lidhje me pranimin apo refuzimin e kërkesës brenda një afati 30 ditor nga dorëzimi i propozimit nga Agjencia. KIS nëse konstaton se dokumentacioni është i paplotë, apo ka nevojë për informacione shtesë, nëpërmjet Agjencisë, i kërkon propozuesit të projektit, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike. Propozuesi i projektit duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.

Në rast se KIS miraton projektin e propozuar dhe i jep statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë", merr një vendim të posaçëm për secilin propozim. Vendimi KIS, përmban:

- titullin e projektit investues;
- vlerën e parashikuar të kapitalit që do të investohet;
- emrin e investitorit të interesuar dhe partnerëve të tij;
- llojin e projektit investues;
- vendin/zonën ku do të zhvillohet ky projekt investues;
- afatin për të cilin jepet statusi "Investim /investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".

Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në regjistrin e investimeve strategjike dhe i njoftohet, me shkrim, kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Në rast se përgjatë përgatitjeve, zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik, KIS konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e këtij projekti në procedurën e asistuar/e veçantë, KIS revokon vendimin për dhënien e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".

- ▶ Asistenca e ofruar për projektet të cilat kanë përfituar statusin "investim strategjik, procedurë e asistuar" ose "investim strategjik, procedurë e veçantë"

Përgjatë zbatimit të procedurës së asistuar apo të veçantë, investitori përfiton asistencën, shërbimet dhe masat mbështetëse që aplikohen në fazën zbatuese të investimit.

3. Faza e realizimit të një projekti strategjik

AIDA dhe organet e tjera të administratës publike, u ofrojnë investitorëve të cilat kanë përfituar statusin "investim strategjik, procedurë e asistuar" ose "investim strategjik, procedurë e veçantë", asistencë dhe shërbime të posaçme, me qëllim zbatimin dhe realizimin e një projekti strategjik. Për zbatimin e investimit strategjik, zbatohen procedurat lehtësuese dhe afatet e përshpejtuara të parashikuara nga legjislacioni mbi investimet strategjike.

Përveç asistencës procedurale dhe shërbimeve të sipërpërmendura, investimet strategjike mund të përfitojnë edhe masa të tjera mbështetëse, të ofruara nga shteti shqiptar.

a) *Asistenca dhe shërbimet e ofruara pas miratimit të statusit strategjik*

I. Asistenca e ofruar për projektet me status investim strategjik, procedurë e asistuar

Pas miratimit të statusit "investim strategjik, procedurë e asistuar", investitori mund të përfitojë këto shërbime dhe lehtësi:

- kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokumenteve dhe aplikim administrativ me procedurë të përshpejtuar;
- trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave, të cilat përfshihen në fushën e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore, për realizimin e investimit strategjik;
- veprime në lidhje me konsolidimin e tokës;
- ofrimin e programeve mbështetëse;
- mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;
- vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike.

II. Asistenca e ofruar për projektet me status investim strategjik, procedurë e veçantë

Pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit "investim strategjik, procedurë e veçantë", investitori mund të përfitojë:

- kryerje e veprimeve përgatitore, përgatitje e dokumenteve dhe aplikim administrativ me procedurë të përshpejtuar;
- trajtim me prioritet të përgatitjes së dokumentacionit, dhënies së mendimeve apo ndjekjen e procedurave, të cilat përfshihen në fushën e veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore, për realizimin e investimit strategjik;
- konsolidim i tokës;
- programe mbështetëse;
- mbështetje me infrastrukturë ndihmëse;
- vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;
- shpronësim të pasurive të paluajtshme, pronë private;
- miratimin nga ana e Kuvendit të kontratave përkatëse të investimit strategjik.

b) Asistenca e ofruar në lidhje me licencat/lejet/autorizimet

AIDA dhe organet e tjera të administratës publike, u ofrojnë investitorëve të cilat kanë përfituar statusin “investim strategjik, procedurë e asistuar” ose “investim strategjik, procedurë e veçantë”, asistencë në lidhje me përgatitjen e aplikimeve dhe përfitimin e licencave/lejeve/autorizimeve të nevojshme për realizimin e një investimi strategjik.

Për këtë qëllim, investitori i interesuar paraqet pranë Agjencisë një dosje të plotë, e cila duhet të përmbajë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga legjislacioni sektorial për miratimin e licencave, së bashku me mandatpagesat e tarifave respektive. AIDA informon investitorët në lidhje me lejet e kërkuara për realizimin e një investimi strategjik dhe dokumentacionin përkatës të tyre.

Agjencia përcjell dosjen e subjektit investues pranë autoriteteve publike, kompetente për lëshimin e këtyre dokumenteve ligjore, brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së dosjes.

Autoritet kompetente, me marrjen e dokumentacionit nga Agjencia, brenda 15 ditëve pune, lëshojnë licencat/lejet/autorizimet, sipas legjislacionit në fuqi.

Përrjashtimisht dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme që lidhen me kompleksitetin e licencave, afati shtyhet vetëm një herë, për një periudhë kohe 15 ditë pune.

Autoritet publike, nëse konstatojnë se dokumentacioni është i paplotësuar, i kërkojnë subjektit investues, vetëm një herë, me shkrim, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së dosjes, plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe të dhënat e kërkuara, duke listuar kërkesat në mënyrë specifike.

Subjekti investues duhet të plotësojë dokumentacionin brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit.

c) Masat mbështetëse shtesë pas miratimit të statusit “investim strategjik, procedurë e asistuar” ose “investim strategjik, procedurë e veçantë”

Shteti shqiptar mund të mbështesë investimet strategjike të miratuara, nëpërmjet masave të mëposhtme mbështetëse:

I. Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse

Shteti shqiptar mund të mbështesë investimin strategjik të miratuar, duke ofruar realizimin e infrastrukturave ndihmëse të cilat shërbejnë për përgatitjen, zbatimin e projektit dhe realizimin e investimit.

Infrastruktura ndihmëse mund të jenë të tilla si rrugë, ujësjellës, kanalizime, energji elektrike dhe telekomunikacion.

Kërkesat e paraqitura për infrastrukturë ndihmëse vlerësohen nga ministria përgjegjëse për ekonominë. Kjo ministri, në bashkëpunim me ministritë e tjera, shqyrton dhe verifikon nevojat dhe kërkesat për infrastrukturë ndihmëse, si dhe vlerëson koston e përafërt për realizimin e tyre, kosto kjo e cila nuk duhet të jetë disproporcionalisht e lartë, në raport me vlerën dhe rëndësinë e projektit investues strategjik.

Mbështetja me infrastrukturë ndihmëse miratohet me vendim nga Komiteti i Investimeve Strategjike. Në rast të miratimit të tyre me vendim të KIS, autoritetet publike kompetente për realizimin e këtyre punëve dhe shërbimeve marrin menjëherë të gjitha masat dhe ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme organizative dhe operacionale për identifikimin dhe plotësimin me prioritet të kërkesave infrastrukturore në fjalë, në mbështetje të investimit strategjik të miratuar.

II. Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore

Në dispozicion të projekteve investuese strategjike, mund të vihen trojet, pyjet, tokat bujqësore, si dhe pasuritë e tjera të paluajtshme, në pronësi të shtetit shqiptar.

Vënia në dispozicion të pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike, rregullohet rast pas rasti, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin mbi administrimin e pronës publike.

Për këtë qëllim krijohet Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS), i cili krijohet nga pasuritë e paluajtshme shtetërore, në pronësi të institucioneve qendrore apo të njësisve të qeverisjes vendore.

FPPMIS krijohet, inventarizohet dhe administrohet nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Transferimi dhe administrimi i pronave shtetërore, pjesë të FPPMIS, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit. Transferimi dhe përfshirja e pronave në FPPMIS përcaktohen, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë.

Propozimi për përfshirjen e një pasurie të paluajtshme shtetërore, si pjesë e FPPMIS, mund të paraqitet nga organet qendrore apo vendore përgjegjëse, si dhe nga investitorët propozues të një investimi strategjik, nëpërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Ministria përgjegjëse për ekonominë inventarizon pronat e përfshira në FPPMIS, ia ofron ato investitorëve strategjikë, si dhe i publikon ato me qëllim informimin, mbështetjen dhe nxitjen e realizimit të investimeve strategjike.

III. E drejta e përdorimit të brigjeve

Lejimi i përdorimit të brigjeve të detit, liqeneve, lumenjve dhe shtretërve të tyre, si dhe zonave përkatëse, në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik, miratohet me vendim të veçantë nga Këshilli i Ministrave, me propozim nga Komiteti i Investimeve Strategjike, pas marrjes së mendimit paraprak nga institucionet, kompetencat e të cilave shtrihen në këto zona.

IV. Pjesëmarrja e shtetit në një investim strategjik

Shteti shqiptar mund të veprojë në rolin e bashkëpjesëmarrësit në investim, sëbashku me investitorë privatë, në rastet kur një investim strategjik, ka interes publik, ka nevojë për mbështetje, si edhe kur është i favorshëm ekonomikisht.

► Format e pjesëmarrjes shtetërore në investim

Pjesëmarrja e shtetit në investimet strategjike mund të realizohet në format e mëposhtme:

- shteti vepron si bashkë zhvillues i investimit strategjik, duke marrë pjesë si ortak/aksionar në shoqërinë tregtare që do të realizojë investimin strategjik, nëpërmjet kontributit në kapital, me para dhe/ose në natyrë. Pjesëmarrja e shtetit në shoqëri do të kryhet sipas mënyrave, formave dhe rregullave të përcaktuar nga legjislacioni tregtar shqiptar;
- shteti vepron si bashkë zhvillues i një zone territoriale të caktuar në të cilën realizohen investime strategjike. Në këtë rast, shteti mund të mbështesë investimin strategjik duke marrë masa për zhvillimin e zonës, të tilla si: përmirësimin dhe zhvillimin e objekteve dhe infrastrukturave ekzistuese, ndërtimin e infrastrukturave të reja ose masave të tjera mbështetëse;
- shteti vepron si bashkëpjesëmarrës në investim në forma të tjera, të tilla si vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme apo të luajtshme, aseteve, makinerive, të drejtave apo lehtës-

ive të ndryshme, dhënien e të drejtës për përdorimin e brigjeve, si dhe kombinime të tyre apo forma të tjera mbështetjeje.

► Përfitimet nga pjesëmarrja në investim

Pjesëmarrja e shtetit në një investim strategjik shpërblehet nëpërmjet pagesës së tarifave, produkteve apo fitimeve të realizuara nga investimi strategjik apo nëpërmjet formave të tjera të përcaktuara. Përfitimet në favor të shtetit përcaktohen në kontratat që nënshkruhen nga shteti me investitorin strategjik.

► Parimet dhe kriteret për pjesëmarrjen shtetërore në investim

Pjesëmarrja e shtetit në investimet strategjike, realizohet në përputhje me interesin publik, duke respektuar parimet e transparencës, paanshmërisë, barazisë dhe mbrojtjes së konkurrencës dhe tregut të lirë.

Pjesëmarrja, mbështetja dhe nxitja shtetërore për një investim strategjik nuk duhet të sjellë, si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Gjithashtu pjesëmarrja shtetërore duhet të jetë në nivele të tilla, të cilat nuk shuajnë ose e reduktojnë ndjeshëm riskun operacional në ngarkim të investitorit strategjik si dhe në nivel të drejtë proporcionaliteti me vlerën dhe rëndësinë e investimit.

Për këtë qëllim, përpara se të vlerësohet pjesëmarrja e shtetit në një investim strategjik, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve i kërkon mendim paraprak Autoritetit të Konkurrencës, Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe organeve të tjerë të specializuar dhe ia përcjell këto mendime Komitetit të Investimeve Strategjike.

Propozimi për bashkëpjesëmarrje shtetërore në një investim strategjik mund të paraqitet nga vetë shteti, në rastin e një projekti strategjik të përgatitur nga organet shtetërore, me qëllim mbështetjen e investitorëve për realizimin e një investimi strategjik.

Bashkëpjesëmarrja e shtetit mund të kërkohet edhe nga vetë investitorët strategjikë të cilët propozojnë realizimin e një investimi strategjik, me qëllim rritjen e nivelit të mbështetjes së projektit, uljen e riskut operacional dhe rritjen e garancive për realizimin e tij.

Në rastet kur propozimi vjen nga një investitor privat, ai duhet të paraqesë pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, përveç dokumentacionit për përfshirjen në procedurat administrative të investimeve strategjike dhe atë mbi garancitë financiare, edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- planin e plotë të biznesit në të cilin përcaktohen edhe ndarja e detyrimeve që propozohen të jenë në ngarkim të investitorit strategjik dhe të shtetit, si edhe kostot përkatëse;
- studimin e plotë të fizibilitetit;
- relacion shpjegues mbi arsyet për të cilat kërkohet përfshirja shtetërore, mënyrën e pjesëmarrjes apo mbështetjes direkte të shtetit në investim dhe një shpjegim të detajuar përse pjesëmarrja shtetërore konsiderohet e nevojshme nga ana e investitorit për suksesin e projektit;
- përshkrimi i formës dhe nivelit të pjesëmarrjes shtetërore të kërkuar;
- identifikimin e asetit publik të luajtshëm ose të paluajtshëm dhe të organit administrues përgjegjës, në rastin kur kërkohet vënia në dispozicion e një asemi publik në pronësi të shtetit;
- projektin e plotë zhvillimor të infrastrukturës së brendshme dhe mënyrën e lidhjes së saj me infrastrukturën e jashtme, në rastin kur kërkohet mbështetja me infrastrukturë mbështetëse;

- të drejta të posaçme që i ofrohen shtetit nga ana e investitorit në kuadër të pjesëmarrjes shtetërore në investim të tilla si por pa u kufizuar në:
 - vendimmarrje me të drejtë veto apo me shumicë të kualifikuar në shoqërinë apo partneritetin që propozohet të krijohet,
 - të drejta të posaçme, përtej atyre të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për të emëruar anëtarë të organeve drejtuese, auditorë, apo për të marrë informacion mbi mbarëvajtjen e investimit,
 - të drejta të posaçme në ndarjen e dividendit, të ardhurave të realizuara apo çdo përfitimi direkt apo indirekt në favor të shtetit,
 - opsionin e daljes së shtetit nga investimi me kushte të paracaktuara apo lehtësisht të vlerësueshme pas një periudhe kohe nga data e pjesëmarrjes së shtetit në investimin strategjik të propozuar,
 - kufizimet e zbatueshme në lidhje me transferimin e pjesëmarrjeve apo pjesëmarrjen e palëve të treta në investim;
 - propozim për zgjidhjen e situatave të bllokimit të vendimmarrjes dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

► Vlerësimi i propozimeve për pjesëmarrje shtetërore në investim

Agjencia, nëpërmjet grupit operacional, vlerëson propozimin si edhe verifikon të gjitha hipotezat, supozimet, zgjidhjet, treguesit, analizat dhe rezultatet e përcaktuara në dokumentet e paraqitura, në mënyrë që të përcaktojë nëse informacioni është i saktë, i zbatueshëm dhe i përshtatshëm për realizimin e investimit.

Për çdo rast të një propozimi për pjesëmarrje të shtetit në një investim strategjik, Agjencia kërkon me shkrim mendimin paraprak të Ministrisë së Financave si dhe ministrisë së linjës që mbulon sektorin e investimit strategjik.

Në rastet kur propozimi i investitorit kërkon njohuri të posaçme që tejkalojnë njohuritë dhe ekspertizën e Agjencisë dhe anëtarëve të grupit operacional, Agjencia mund të kërkojë nga investitori propozues që të përballojë kostot për angazhimin nga ana e Agjencisë të ekspertëve të jashtëm të pavarur. Procedura e përzgjedhjes së ekspertëve të jashtëm kryhet nga vetë Agjencia e cila përzgjedh dhe angazhon ekspertët përkatës sipas një procedure të hapur dhe transparente pasi investitori propozues të ketë dhënë pëlqimin me shkrim për mbulimin e kostos përkatëse.

Agjencia negocion me investitorin propozues një projekt të dokumenteve që do të nënshkruhen nga palët në rast miratimi të pjesëmarrjes së shtetit në investim që sipas rastit dhe formës së pjesëmarrjes përfshijnë por pa u kufizuar në:

- aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë ku shteti do të marrë pjesë si ortak/aksionar e cila duhet të përfshijë të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e secilës palë në shoqërinë ku shteti merr pjesë;
- marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve në rastet kur shteti merr pjesë në investim nëpërmjet formave të ndryshme nga ajo e pjesëmarrjes në shoqëri. Në secilin nga këto dokumente përmbajtja duhet të reflektojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar të drejtat dhe detyrimet e secilës palë pjesëmarrëse në investim në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe propozimin e investitorit;

Procesi i vlerësimit i kryer nga Agjencia kryhet brenda 30 ditësh nga marrja e dokumentacionit të plotësuar nga ana e investitorit propozues. Në përfundim të procesit të vlerësimit, pas miratimit nga ministri përgjegjës për ekonominë, Agjencia i përcjell KIS propozimin e paraqitur, dokumentacionin përkatës, mendimet e organeve të tjera shtetërore të përfshira si dhe vlerësimin e saj mbi propozimin.

Brenda 30 ditësh nga përcjellja e kërkesës nga Agjencia, KIS vendos në lidhje me propozimin për pjesëmarrjen shtetërore në investimin strategjik. KIS mund të vendosë të pranojë propozimin e paraqitur, ta pranojë me kushte apo ta refuzojë atë.

KIS mund të vendosë që pranimit të propozimit të kushtëzohet me plotësim të informacionit, të dhënave apo garancive të investitorit për realizimin e investimit si dhe me kërkesën për ndryshim në kushtet e bashkëpunimit të propozuara të tilla si; vlera apo lloji i kontributit, forma e pjesëmarrjes apo të drejtat dhe detyrimet kryesore të palëve në shoqërinë e përbashkët apo në marrëveshjen e propozuar të investimit. Në këto raste KIS i kthen dokumentacionin Agjencisë e cila komunikon me investitorin propozues në lidhje me kërkesat e parashtruara nga KIS. Në rast se, brenda një afati prej 30 ditësh nga data e njoftimit, investitori propozues pranon kushtet e vendosura nga KIS, Agjencia paraqet përsëri pranë KIS për vendimmarrje dokumentacionin e ndryshuar i cili reflekton sugjerimet e KIS.

Refuzimi i pjesëmarrjes së shtetit në investim nuk cenon përfitimin e statusit investim strategjik procedurë e veçantë/asistuar në rast se investitori deklaron se dëshiron të vazhdojë me kryerjen e investimit pavarësisht mospjesëmarrjes shtetërore.

Në rastet kur KIS vendos të pranojë propozimet për bashkëpjesëmarrje, ia përcjell për miratim Këshillit të Ministrave.

Propozimi i KIS duhet të tregojë formën, nivelin dhe mënyrat e pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik dhe duhet të shoqërohet nga një relacion në të cilin arsyetohet në mënyrë të detajuar;

- interesi publik dhe arsyet për të cilat konsiderohet e nevojshme pjesëmarrja shtetërore në investim;
- analiza ekonomike e investimit strategjik dhe e pjesëmarrjes shtetërore;
- vlerësimi i avantazheve dhe rreziqeve të pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik;
- niveli i pjesëmarrjes shtetërore në raport me vlerën totale të investimit;
- shkalla e ndarjes së riskut operacional midis shtetit dhe investitorit strategjik;
- ndikimet mbi tregun e lirë dhe konkurrencën që sjell pjesëmarrja e shtetit në investim;
- projekt marrëveshjen në lidhje me kushtet, të drejtat dhe detyrimet e palëve në realizimin e pjesëmarrjes shtetërore në investimin strategjik

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim, rast pas rasti, formën, nivelin dhe mënyrat e pjesëmarrjes shtetërore në një investim strategjik. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton edhe organin shtetëror i cili autorizohet për lidhjen e kontratës me investitorin strategjik si edhe për ndjekjen, zbatimin dhe monitorimin e saj.

Masat mbështetëse të mësipërme, nuk aplikohen për kontratat e investimeve të nënshkruara para hyrjes në fuqi të ligjit për investimet strategjike (datë 01 Tetor 2015).

d) Masa mbështetëse të posaçme për investimet strategjike me procedurë të veçantë

I. Shpronësimet për interes publik

Përveç masave mbështetëse të mësipërme, investimet strategjike me procedurë të veçantë mbështeten edhe nëpërmjet ofrimit të masave të tjera shtesë, si shpronësimi dhe miratimi i kontratave përkatëse të investimit strategjik nga ana e Kuvendit.

Për të mundësuar realizimin e projekteve investuese strategjike, të cilat kanë përfituar statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", si dhe të punëve dhe shërbimeve mbështetëse infrastrukurore, lejohet shpronësimi për interes publik, në përputhje me legjislacionin për shpronësimin për interes publik.

Kompensimi financiar që nevojitet për realizimin e shpronësimeve mbulohet nga subjekti që ka pa-

raqitur kërkesën për shpronësim.

Shpronësimi për qëllimet e realizimit të investimeve strategjike lejohet vetëm në rastet kur investitori, nuk ka mundur ta zgjidhë me marrëveshje me pronarin privat, situatën e pronësinë mbi pasurinë e paluajtshme. Për këtë qëllim investitori është i detyruar të kryejë përpikmërisht procedurën e posaçme të parashikuar nga VKM nr. 1032, datë 16.12.2015, "Për dokumentimin e marrëveshjeve të investitorëve strategjikë me pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private".

Agjencia i jep investitorëve të gjithë informacionin dhe të dhënat e kërkuara, nëpërmjet asistencës ndërinstitucionale me organet përkatëse. Njëkohësisht, Agjencia monitoron respektimin nga ana e investitorit të procedurave për arritjen e marrëveshjeve me pronarët, duke verifikuar informacionin dhe dokumentet e paraqitura nga investitori për këtë procedurë.

II. Miratimi i kontratës së investimit strategjik, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Për të mundësuar realizimin e projekteve investuese strategjike, të cilat kanë përfutur statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë", investitori strategjik mund të kërkojë, si masë e cila rrit sigurinë e marrëdhënies juridike të rregulluar përmes tij dhe shtetit shqiptar, miratimin nga ana e Kuvendit, të kontratës përkatëse të investimit strategjik.

Kërkesa e investitorit, duhet të vlerësohet paraprakisht nga Këshilli i Ministrave, i cili në rast se është në interesin publik dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, i propozon Kuvendit miratimin e kontratës përkatëse të investimit strategjik, me ligj të veçantë.

4. Tarifat e procedurave të investimeve strategjike

Për shërbimet në favor të projekteve dhe investitorëve strategjikë që ofrohen nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve aplikohen tarifat e mëposhtme:

- a) **tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative;**
- b) **tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike.**

* * *

a) **Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative**

Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative, mbulon kostot dhe shpenzimet për të gjitha shërbimet e kryera nga Agjencia, duke nisur që nga momenti i paraqitjes së aplikimit e deri në momentin e marrjes së vendimit nga ana e Komitetit të Investimeve Strategjike, në lidhje me miratimin ose jo të statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Këto shërbime përfshijnë, por pa u kufizuar:

- shkëmbimet e informacionit;
- komunikimet postare;
- kopjet e akteve shkresore dhe/ose elektronike të cilat Agjencia i merr ose i transmeton investitorit dhe organeve shtetërore të përfshira në procedurat e investimeve strategjike.
- Shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti investues i interesuar;
- analizën paraprake të profilit të investitorit, përfshirë studimin e deklaratave financiare, strukturës menaxheriale, pronësisë, pozicionimit në treg, eksperiencave të mëparshme;
- vlerësimin teknik, financiar dhe strategjik të projektit të investimit strategjik, të potencialit strategjik të tij, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e tij;

- shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, shërbime përfaqësimi të investitorit tek organet shtetërore;
- mbështetjen paraprake të një projekti me potencial strategjik, përfshirë asistencën ndaj subjektit investues për mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor, administrativ etj, të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e investimit;
- shërbimet në lidhje me negocimin, lidhjen dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me investitorin.

Tarifa e kostove dhe e shërbimeve administrative ka një kosto fikse prej 70.000 lekësh. Pagesa e kësaj tarife kryhet nga subjektet e interesuar në momentin e aplikimit për kryerjen e veprimeve dhe procedurave të investimeve strategjike, pranë Agjencisë.

a) tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike.

Tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike, përfshin të gjitha shërbimet mbështetëse që kryen Agjencia në procedurat e investimeve strategjike, pas përfitimit të statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Këto shërbime përfshijnë, por pa u kufizuar:

- kryerjen e veprimeve përgatitore, përgatitjen e dokumenteve dhe aplikimin administrativ me procedurë të përshpejtuar, përfshirë dokumentet e nevojshme që shoqërojnë aplikimin;
- trajtimin me prioritet i përgatitjes së dokumentacionit, dhënien e mendimeve dhe ndjekjen e procedurave;
- veprime për konsolidimin e tokës, të cilat kanë si qëllim ripërshtatjen dhe ristrukturimin e planifikuar të parcelave të tokës dhe pronësisë së tyre. Këto veprime mund të përfshijnë ndryshimin e formës, pronësisë, të regjimit juridik dhe shfrytëzimit të tokës, ose kombinime të tyre;
- përgatitjen dhe ofrimin e programeve mbështetëse;
- veprime në lidhje me realizimin e procedurave për mbështetjen me infrastrukturë ndihmëse;
- vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike.
- dërgimin e dosjes së subjektit investues për marrjen e licencave/lejeve/autorizimeve, pranë organeve publike kompetente.
- veprimet mbështetëse në lidhje me shpronësimin e pasurive të paluajtshme, pronë private, për të mundësuar zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike;
- veprimet për përgatitjen dhe përcjelljen për miratim nga ana e Kuvendit të kontratave përkatëse të investimit strategjik, në përputhje me raste dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Tarifa e menaxhimit të procedurave të investimeve strategjike ka një kosto fikse prej 15.000 lekësh.

Pagesa e kësaj tarife kryhet nga subjektet e interesuar dhe dorëzohet së bashku me dokumentacionin e kërkuar për miratimin e statusit "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar", apo "Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Këto tarifa nuk përfshijnë tarifat dhe shpenzimet e tjera të cilat aplikohen nga legjislacioni në fuqi, për marrjen e lejeve, licencave apo autorizimeve, apo për veprime të tjera në lidhje me projektin apo investimin strategjik. Kostot përkatëse për përbalimin e tyre përballohen nga investitori dhe paguhen së bashku me tarifat e përcaktuara nga ky vendim.

Tarifat e investimeve strategjike nuk aplikohen për shërbimet e kryera nga Agjencia për mbështetjen paraprake të një projekti strategjik, në rastet kur propozuesi është një organ shtetëror.



ORGANET LIGJZBATUESE

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
2. Grupi Operacional
3. Komiteti i Investimeve Strategjike
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes
5. Ministrinë e linjës
6. Këshilli i Ministrave
7. Organe të tjera publike

C. ORGANET LIGJZBATUESE

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

AIDA është struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve në një "dritare unike" për investitorët dhe projektet, të cilat kërkojnë të përfitojnë statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë", për projektet potenciale strategjike dhe investitorët potencialë.

AIDA ndjek të gjitha procedurat administrative të parashikuara, që nga momenti i paraqitjes së një propozimi investues e deri në përfundimin e të gjitha procedurave administrative për realizimin e projektit investues.

AIDA kryen analizën paraprake të investitorëve dhe projekteve të paraqitura dhe për këtë qëllim ka të drejtë t'i kërkojë investitorit informacione lidhur me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e investimit, deklaratat financiare, strukturën menaxheriale, pronësinë, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme, lidhur me fushën e investimit, projekte të ngjashme, si dhe komponentë të tjerë të nevojshëm për të provuar aftësitë e tij investuese dhe potencialin për të qenë investitor strategjik.

Pranë Agjencisë funksionon sekretariati teknik, i cili kryen rolin e Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike, duke mundësuar dhe duke dhënë të gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve dhe të veprimtarisë së KIS.

AIDA kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë, ofron shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, si dhe shërbime përfaqësimi të investitorit tek autoritetet publike në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

AIDA drejton procesin e vlerësimit të propozimeve, në bashkëpunim me grupet operacionale.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të kryer sëbashku me grupet operacionale, AIDA harton rekomandimet përkatëse në lidhje me miratimin ose jo të statuseve preferenciale ndaj projekteve dhe investimeve të propozuara.

AIDA administron regjistrin e investimeve strategjike, i cili është baza e të dhënave për çdo investim strategjik që kryhet në Republikën e Shqipërisë.

AIDA raporton pranë Komitetit të Investimeve Strategjike mbi zbatimin e të gjitha detyrave dhe procedurave që nga momenti i paraqitjes së një propozimi investues e deri në realizimin e investimit.

AIDA zhvillon dhe blen shërbime të promovimit, nxitjes dhe tërheqjes së investimeve strategjike, duke promovuar klimën e biznesit, procedurat lehtësuese, masat mbështetëse dhe kuadrin ligjor favorizues për investimet strategjike, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Grupi Operacional

Grupi operacional është grupi i posaçëm i punës, i cili përbëhet nga ekspertë të ministrive të fushave në të cilat kërkohet të realizohet investimi strategjik, për të asistuar dhe mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin çdo projekti strategjik.

Grupi operacional ngrihet rast pas rasti, për çdo propozim të paraqitur, pranë AIDA dhe kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i saj, i cili përfaqëson grupin në marrëdhëniet me organet shtetërore dhe investitorët strategjikë.

Ky grup ka detyrën për të asistuar dhe mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedura-

ve dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik të veçantë.

Në veçanti grupi operacional ka këto detyra:

- përcakton procedurat e detajuara në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e çdo projekti individual, informimin e investitorit dhe të institucioneve të interesuara;
- kryen veprime që lidhen me paraqitjen e zhvillimin e projektit dhe që mbështesin kryerjen e investimit strategjik dhe hartimin e një liste masash e dokumentesh që duhet të përmbajë dhe/ose që duhet të merren për të realizuar projektin e investimit strategjik, përmes sistemit të "dritares unike", me procedurë të përshpejtuar;
- bën vlerësimin teknik, ekonomik dhe financiar të projektit të investimit strategjik, të potencialit strategjik të tij, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e këtij projekti.
- harton dhe propozon planin e veprimit për secilin propozim investues, duke filluar që nga momenti i paraqitjes së një propozimi investues e deri në përfundimin e të gjitha procedurave administrative të parashikuara.

Grupi operacional, rast pas rasti, në varësi të çështjes, kërkon mendim nga Autoriteti i Konkurrencës, njësitë përkatëse të qeverisjes vendore apo agjenci ose institucione të tjera.

► Procedura e ngritjes së grupit operacional

Grupet operationale ngrihen rast pas rasti, me propozimin e AIDA, me nismën e ministrit përgjegjës për ekonominë, me anë të një urdhëri të përbashkët të ministrave të përfshirë në projektin e investimeve strategjike. Me qëllim respektimin e afateve të përshpejtuara të procedurave administrative, për investimet strategjike, ministrat përgjegjës për projektin strategjik, brenda 10 ditëve, nga marrja e kërkesës së ministrit përgjegjës për ekonominë, përcaktojnë personat pjesëmarrës në grupin operacional, si dhe personat/strukturat e kontaktit, të cilët do të jenë përgjegjës për komunikimet me agjencinë, në lidhje me investimet strategjike.

Urdhëri i përbashkët për ngritjen e grupit operacional të punës, përcakton:

- qëllimin e ngritjes së grupit;
- objektin e tij;
- funksionimin e grupit në strukturën e agjencisë;
- numrin e punonjësve që do të përfshihen dhe ndarjen e detyrave përkatëse;
- rregullat për vendimmarrjen e grupit;
- përcaktimin e infrastrukturës, nëse është e nevojshme;
- mjetet financiare, nëse është e nevojshme;
- afatet, brenda të cilit grupi i punës duhet të realizojë detyrat e tij.

3. Komiteti i Investimeve Strategjike

Komiteti i Investimeve Strategjike është organi administrativ kolegjal, ndërministror i cili funksionon pranë Këshillit të Ministrave. KIS përbëhet nga këta anëtarë:

- Kryeministri - Kryetar
- Zëvendëskryeministri - Zëvendëskryetar;

- ministri përgjegjës për çështjet e financave;
- ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë dhe turizmit;
- ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës dhe transportit;
- ministri përgjegjës për çështjet e energjisë dhe industrisë;
- ministri përgjegjës për çështjet e zhvillimit urban;
- ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë;
- ministri përgjegjës për mjedisin;
- Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit;
- rast pas rasti, ministrat e tjerë përgjegjës, kur çështjet që do të diskutohen u përkasin fushave të përgjegjësisë që ata mbulojnë.

Rolin e Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike e kryen Agjencia, e cila mundëson të gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve.

► **Kompetencat e KIS:**

- monitoron funksionimin e sistemit të “dritares unike” për shërbimet ndaj investitorit strategjik;
- monitoron performancën e ndikimit të investimeve strategjike e të ecurisë së tyre;
- miraton programet konkrete për mbështetjen dhe stimujt për investimet strategjike;
- miraton planin e veprimit për masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e një projekti investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit;
- miraton projektet me statusin “projekt me potencial strategjik”.

Komiteti i Investimeve Strategjike, në varësi të karakteristikave, përmasave dhe kompleksitetit të projektit, eksperiencës dhe kapaciteteve të investitorit si dhe në varësi të interesit publik, përcakton nivelin e përqindjes së kapaciteteve financiare të kërkuara ndaj investitorëve, brenda kufijve minimale dhe maksimale të parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike.

4. **Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes**

Ministria përgjegjëse për ekonominë monitoron veprimtarinë e Agjencisë në rolin e “dritares unike”, në kuadër të zbatimit të detyrave funksionale e të ofrimit të shërbimeve për investitorin, si dhe treguesit e cilësisë së shërbimeve që kryen Agjencia.

Ministria përfshihet në procesin e vlerësimit për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik”, “statusin “investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar” ose “investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë, duke dhënë miratimin e saj paraprak, përpara se projektet dhe investimet të paraqiten për miratim Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ministria përgjegjëse për ekonominë krijon, inventarizon dhe administron Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike.

Gjithashtu, ministri përgjegjës për ekonominë kryen vlerësimin përfundimtar të oportunitetit dhe i propozon Këshillit të Ministrave përfshirjen e pasurive të paluajtshme në FPPMIS.

Ministria përgjegjëse për ekonominë inventarizon pronat e përfshira në FPPMIS, ia ofron ato investitorëve strategjike si dhe i publikon ato, me qëllim informimin, mbështetjen dhe nxitjen e realizimit të investimeve strategjike.

Ministri përgjegjës për ekonominë, merr iniciativën për ngritjen e grupeve operationale të cilat vlerësojnë investimet dhe projektet strategjike të paraqitura për miratim.

Ministri përgjegjës për ekonominë mund të jetë propozues i miratimit të projekteve me potencial strategjik, për investime të cilat kryhen në sektorët ekonomikë brenda kompetencave të tij.

5. Ministrinë e linjës

Ministrat e linjës mund të jenë propozues të projekteve me potencial strategjik, të cilat kanë si objekt investime të cilat kryhen në sektorët ekonomikë brenda kompetencave të ministrive përkatës. Ministrinë e linjës dërgojnë përfaqësuesit e tyre në grupet operationale që vlerësojnë propozimet e projekteve dhe investimeve strategjike të cilat i përkasin veprimtarisë dhe kompetencave të ministrisë.

Gjithashtu ministrinë e linjës bashkëpunojnë dhe i japin informacion, të dhëna dhe dokumentacionin që i kërkohet nga AIDA, në kuadër të procedurave administrative sipas legjislacionit për investimet strategjike.

6. Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave miraton me vendim aktet nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë".

Këshilli i Ministrave, përcakton me vendim, rast pas rasti, formën, nivelin dhe mënyrat e pjesëmarrjes shtetërore në një investim strategjik.

Këshilli i Ministrave, miraton me vendim të veçantë transferimin dhe administrimin e pasurive të paluajtshme shtetërore të cilat përfshihen në FPPMIS në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit, si edhe përcakton rregullat për përballimin e shpenzimeve për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurive të paluajtshme pjesë e FPPMIS

Këshilli i Ministrave miraton me vendim të veçantë, lejimin e përdorimit të brigjeve të detit, liqeneve, lumenjve dhe shtretërve të tyre, si dhe zonave përkatëse, në funksion të realizimit të një projekti investues strategjik.

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim të veçantë, zonat rajonale dhe/ose lokale të qeverisjes vendore të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi dhe përcakton rregullat e hollësishme për funksionimin e tyre.

Në rastet kur e vlerëson të arsyeshme, me kërkesë të investitorit strategjik për të rritur sigurinë e marrëdhënies juridike të rregulluar përmes tij dhe shtetit shqiptar, Këshilli i Ministrave i propozon Kuvendit miratimin e kontratave të investimit strategjik,

Nëse për realizimin e një projekti potencial strategjik, procedurë e veçantë, përfshihen disa sektorë dhe nevojitet kryerja e disa procedurave konkurruese/ tenderuese/koncesionare nga autoritete të ndryshme, Këshilli i Ministrave mund:

- të unifikojë projektin e investimit strategjik, duke përcaktuar si autoritet kontraktues sektorin me rëndësi më të madhe në investim, në varësi të natyrës së projektit të investimit strategjik;
- të bashkojë procedurat për vendimmarrjen për t'u trajtuar nga një autoritet i vetëm kontraktues ose me bashkëfirmosje.

7. Organe të tjera publike

Të gjitha institucionet/entet/autoritetet publike shtetërore detyrohen të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, në rolin e "dritares unike" për ofrimin e shërbimeve ndaj investitorit, me kërkesën e saj, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik..

Në rastet kur vlerësohet pjesëmarrja e shtetit në një investim strategjik, Agjencia i kërkon mendim, Ministrisë së Financave, ministrisë së linjës që mbulon sektorin e investimit strategjik, Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

Në rastet kur vlerësohen propozimet për përfshirjen e pasurive të paluajtshme shtetërore si pjesë e FPPMIS, ministri përgjegjës për ekonominë bashkëpunon dhe i kërkon informacion Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale, zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme si edhe gjykatave kompetente.

Në procesin e përfshirjes së pasurive të paluajtshme shtetërore si pjesë e FPPMIS, konsultohen, japin mendim paraprak apo paraqesin propozime, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore të cilat administrojnë pronat e paluajtshme shtetërore të propozuara për tu përfshirë në FPPMIS.



BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

1. Procedurat dhe afatet për shkëmbimin e informacionit
2. Masat disiplinore për mospërbushjen e detyrave
3. Kundërvajtjet administrative

D. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

1. Procedurat dhe afatet për shkëmbimin e informacionit

AIDA, në rastet kur, përgjatë ushtrimit të funksioneve të saj në lidhje me investimet strategjike, i nevojiten të dhëna apo informacione që disponohen nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, ka të drejtë që, nëpërmjet procedurës së përshpejtuar, të kërkojë sigurimin e të dhënave, informacioneve apo çdo lloj ndihme tjetër të nevojshme për realizimin e detyrave funksionale.

Kërkesa për informacion ose të dhëna e agjencisë, drejtuar organeve të tjera, duhet të përmbajë:

- llojin e të dhënave apo informacionit që kërkohet për një investim strategjik;
- argumentimin e trajtimit të procedurës me prioritet, si rrjedhojë e parashikimeve të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë";
- afatin, brenda të cilit duhen dërguar të dhënat apo informacioni i kërkuar;
- nënshkrimin e titullarit të institucionit apo personit përgjegjës.

Organet publike shtetërore, të cilat marrin një kërkesë për informacion nga AIDA, duhet të kthejnë përgjigje për kërkesën për bashkëpunim, bashkë me informacionin dhe të dhënat e kërkuara, brenda një afati maksimal prej 7 ditësh pune.

Institucioni pritës, për shkaqe me rëndësi dhe duke dhënë një përgjigje të arsyetuar, mund të shtyjë përgjigjen e tij, sipas rastit, deri në 3 ditë pune të tjera.

Në rastin kur kërkohen të dhëna apo informacione, për të cilat kërkohen njohuri dhe ekzaminime të posaçme, afati për kthimin e përgjigjes është jo më shumë se 20 ditë pune.

Në rast se përgjigjja, informacioni apo të dhënat e kërkuara nuk janë të plota, AIDA ka të drejtë të kërkojë plotësimin e tyre, brenda 3 ditëve pune, nga marrja e kërkesës për plotësim informacioni

2. Masat disiplinore për mospërbushjen e detyrave

Veprimi ose mosveprimi nga nëpunësi publik apo punonjësi, në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit për investimet strategjike, konsiderohet mospërbushje e rëndë e detyrës dhe përbën shkak për fillimin e procedurës disiplinore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", ose Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

3. Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave të ligjit për investimet strategjike, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- mospërbushja e detyrimit të bashkëpunimit të organeve publike me AIDA, dënohet me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500.000 (pesëqind mijë) lekë;
- mosrespektimi i afateve të procedurës së përshpejtuar, dënohet me gjobë në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Autoriteti kompetent për vendosjen e gjobës është Agjencia.





ANEKSI 1 - PËRKUFIZIMET LIGJORE
ANEKSI 2 - LISTA E SHKURTIMEVE

ANEKSI 1 - PËRKUFIZIME LIGJORE

- “Dritare unike” është institucioni përgjegjës i shërbimeve ndaj projektit/investitorit strategjik.
- “Ferma e madhe bujqësore” është një sasi e konsiderueshme toke bujqësore e shfrytëzueshme për përpunimin intensiv të kulturave bujqësore, që gjeneron ndikim në ekonomi dhe punësim, koncepti i së cilës mund të shërbejë si model edhe për ferma të tjera.
- “Grupi operacional” është grupi i posaçëm i punës, i cili përbëhet nga ekspertë të ministrive të linjës, të fushave në të cilën/at kërkohet të realizohet investimi strategjik për të asistuar dhe mbështetur profesionalisht në ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgatitjen e të gjitha akteve e dokumenteve ligjore, me qëllim përgatitjen, zbatimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik të veçantë.
- “Investime strategjike” janë investimet e kryera në një nga sektorët ekonomikë strategjikë, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
- “Komiteti i Investimeve Strategjike” është organi administrativ kolegjal pranë Këshillit të Ministrave, i përcaktuar në këtë ligj.
- “Konsolidimi i tokës” është ripërshatja dhe ristrukturimi i planifikuar i parcelave të tokës dhe i pronësisë së tyre. Kjo mund të përfshijë ndryshimin e formës, pronësisë/regjimit juridik dhe shfrytëzimit të tokës, në çdo kombinim.
- “Marrëveshje mirëkuptimi” është marrëveshja përgjithësisht jodetyruese për shërbimet ndaj projektit strategjik dhe investitorit potencial strategjik, në të cilën parashikohen zotimet dhe premtimet e ndërsjella të palëve për përgatitjen, hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik.
- “Procedurë e asistuar” është procedura administrative e parashikuar në këtë ligj, me të cilën administrata publike ndjek, koordinon, asiston, mbikëqyr dhe, sipas rastit, përfaqëson investimin strategjik përgjatë fazave të zbatimit të tij.
- “Procedurë e veçantë” është procedura administrative e parashikuar në këtë ligj, me të cilën jepet mbështetje me rregulla të veçanta për investime strategjike me ndikim në ekonomi, punësim, industri, teknologji dhe/ose zhvillim rajonal, me synim lehtësimin dhe përsheptimin e investimeve.
- “Projekti potencial strategjik” është projekti i mundshëm i investimit me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik, i cili klasifikohet si i tillë që nga momenti i nismës për të hartuar projektin nga promovuesi i projektit deri në momentin e përfitimit të statusit “Investim/investitor strategjik”.
- “Regjistri i investimeve strategjike” është baza e të dhënave për çdo investim strategjik që do të kryhet në Republikën e Shqipërisë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i cili do të administrohet nga Agjencia.
- “Risku operacional” është risku i humbjeve si pasojë e dështimeve apo pamjaftueshmërisë së burimeve, proceseve, sistemeve apo rrethanave të tjera të jashtme.
- “Sektorë strategjikë” janë sektorët ekonomikë, të përcaktuar sipas këtij ligji, të cilët konsiderohen nga shteti shqiptar me potencial të lartë për zhvillimin e ekonomisë së vendit.
- “Statusi “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”” është statusi i miratuar nga Komiteti i Investimeve Strategjike, i cili u jepet personave juridikë privatë, vendas dhe të huaj, të cilët kërkojnë të realizojnë një projekt investues, të kualifikuar si strategjik nga ky ligj përgjatë të gjitha fazave të ndërtimit, zbatimit të projektit strategjik dhe operimit të investimit/veprës strategjike.

- “Subjekte investuese strategjike” janë subjektet investuese të interesuara për zhvillimin dhe realizimin e një investimi të kualifikuar si strategjik, sipas këtij ligji. Subjekte investuese strategjike mund të jenë personat juridikë privatë, vendas dhe të huaj.
- “Vlera e investimit” është vlera totale e investuar nga investitori deri në momentin që projekti bëhet operacional.
- “Zona me përparësi zhvillimi” janë zonat rajonale dhe/ose lokale të qeverisjes vendore, të përcaktuara si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave, të cilat konsiderohen për mbështetje të posaçme për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe punësimin.

ANEKSI 2 - LISTA E SHKURTIMEVE

- **KIS** - Komiteti i Investimeve Strategjike
- **KM** - Këshilli i Ministrave
- **MZHETTS** - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
- **AIDA ose Agjencia** - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
- **GO** - Grupi Operacional
- **LIS** - Legjislacioni për Investimet Strategjike
- **FPPMIS** - Fondi i Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike
- **ALUIZNI** - Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES

AIDA

Albanian Investment Development Agency

Building 07, Tirana Business Park
Rinas Road, Tirana | Albania

☎ +355 042 251001

📄 +355 042 250970

✉ info@aida.gov.al

🌐 www.aida.gov.al

